



» Lezhë | Rruga e ndërtuar vetëm pak kohë më parë po kthehet jo funksionale. Muret metalike vidhen për tu shitur për skrap

Grabiten mbrojtësit anësorë në rrugën Lezhë-Kallmet

LEZHË- Rruga Lezhë-Kallmet është konsideruar si një ndër investimet më të rëndësishme në qarkun e Lezhës për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Në këtë rrugë prej vitesh nuk ishte vënë dorë. Ndërsa në prill të 2009 u bë e mundur nisja e zbatimit të projektit "Rikonstruksion i Rrugës Lezhë-Kallmet", me një shumë prej 338.3 milionë lekë të investuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, financuar nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare në kudër të programit "Përmirësimi i rrugëve dytësore rurale". Me përfundimin e ndërtimit të veprave të artit, asfaltimit të rrugës si edhe ndërtimit të trotuareve nga qyteti tek varrezat publike si

edhe në qendrat e fshatrave, gjatë muajit shtator është vendosur edhe sinjalistika rrugore si horizontale ashtu edhe vertikale duke i dhënë kështu konturimin rrugës me të gjitha parametrat. Ende pa u bërë ceremonia e inaugurimit të kësaj rruge tepër të rëndësishme jo vetëm për komunitetin e Bashkisë së Lezhës, Komunës së Kallmetit, por edhe Blinishtit dhe të Ungrejt, kanë nisur të shfaqen dëmtimet e para, të shkaktuara nga dora e njerëzve të papërgjegjshëm. Gjatë një vëzhgimi të bërë në të gjithë segmentin nga qyteti i Lezhës dhe deri në Kallmet, u vu re se një pjesë e mirë e mbrojtësve metalike anësorë janë dëmtuar,

kjo më e theksuar tek barrierat e ndërtuara në ura. Sipas pohimeve të banorëve, mësohet se ato janë hequr në orët e natës gjatë javës së kaluar, pasi ditën në këtë rrugë ka lëvizje të mëdha si nga automjetet ashtu edhe nga banorët. Këto elemente të grabitur dyshohet të jenë shitur më pas personave të tjerë të cilët edhe ata i tregtojnë për skrap. Barrierat janë ndërtuar për të parandaluar aksidentet, por fatkeqësisht ato po bien pre e grabitjeve vetëm pak ditë pas vendosjes së tyre. Deri tani asnjë person nuk është vënë përpara përgjegjësisë për grabitjen e elementëve metalikë të mbrojtësve anësorë të rrugës Lezhë-Kallmet.

Lindita Kokaj